

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë, 15/01/2013
Nr. 0203-20-2

PËR: Isni Kilaj, Kryetar i Komunës së Malishevë
Ragip Begaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Malishevë

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË RREGULLORES PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE Nr .02 L03

Pranuar, 09.01. 2013

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores së Qeverisë 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, Pas shqyrtimit të Rregullores Nr. 02 L03, për Përdorimin e Gjuhëve, të miratuar me datë 28.12.2012, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i listuar si në vijim, ka efekt të plotë juridik;

- Rregullorja për Përdorimin e Gjuhëve në Komunën e Malishevës.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së
Drejtorëve të Departamenteve dhe Zyrave
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum, 15/01/2013
br. 0203-20-2

Za: Isni Kilaj, Gradonačelnik opštine Mališevo
Ragip Begaj, Predsedavajući Skupštine opštine Mališevo

Predmet: Potvrda zakonitosti uredbe o upotrebi jezika br .02 L03

Primljeno , 09.01. 2013

Poštovani/e

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, u skladu sa njenim mandatom definisano zakonom br. 03/z-040 o lokalnoj samoupravi , dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim administrativnim oblastima kancelarije premijera i ministarstva, nakon razmatranja uredbe br. 02 z03, o upotrebi jezika odobreno dana 28.12.2012. **POTVRĐUJE zakonitost ovog akta i procenjuje da isti taj je u potpunom skladu sa zakonom o loklanoj samouprvi .**

Pravni akat sa potpunim pravnim dejstvom je kao što sledi;

- Uredba o upotrebi jezika u opštini Mališevo.

Sa poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik premijera i Ministar MALS-a,

Kopija: Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a
Direktorima odeljenja i kancelarija
Arhivi MALS-a

REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

FRANJAF ME

ACCEPTED ON

PRIMLJENO:

Nr.No.Br.

02/04

Kuvendi i Komunës

Nr. 02/

Datë: 08.01.2013

Në pajtim me dispozitat e nenit 9 dhe 12 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale Ligji nr.03/L-040, të dispozitave të nenit 7 të Ligjit për përdorimin e gjuhëve nr.02/L-37 dhe dispozitave të nenit 12 dhe 19 të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 të datës, 12.11.2008, rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa nr. 02/265 të datës, 20.12.2012

Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e mbajtur me datë, 28.12.2012, mori këtë :

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE NË KOMUNËN E
MALISHEVËS

Neni 1

Miratohet, Rregullorja për përdorimin e Gjuhëve në Komunën e Malishevës.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdeset Kryetari i Komunës, përmes organeve kompetente.

Neni 3


Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit nga ana e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Malishevës.

Vendimi u dërgohet;

Arkivit

Organeve kompetente

MAPL-së



Kryesuesi i Kuvendit

Rajip Begaj

HYRË BË-ULAZNA-INGOMINO
 REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLICA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVO

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministarshva Lokalne Samouprave i Administracije
 Ministry of Local Government Administration

Data
 Datum 09.01.2013

Niveli Organizave	Nr. i Lëndës	Smjeza	Vite
- III -	0203-20	1	

REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

08-01-2013
 02/03

RREGULLORE PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE NË
 KOMUNËN E MALISHEVËS

Malishevë 2012

Në pajtim me dispozitat e nenit 9 të Ligjit nr. 03/L - 040 për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), të dispozitave të nenit 7 të Ligjit për përdorimin e gjuhëve nr. 02 / L - 37 dhe të dispozitave të nenit 12 të Statutit të Komunës së Malishevës 01. nr. 871, të dt. 12.11.2008,

Kuvendi i Komunës së Malishevës, në mbledhjen e mbajtur më, 28.12.2012, miratoi

RREGULLOREN

PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE NË KOMUNËN E MALISHEVËS

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Qëllimi

Neni 1

1.1 Qëllimi i kësaj Rregulloreje është:

- a) të rregullojë përdorimin e gjuhëve zyrtare në organet e Komunës, institucionet arsimore, institucionet e shëndetësisë dhe ndërmarrjet publike lokale;
- b) të ofrojë udhëzime mbi mënyrën me të cilën përfaqësuesit komunalë, organet e administratës dhe ndërmarrjet publike lokale, do t'i përmbushin obligimet e tyre në lidhje me përdorimin e gjuhëve zyrtare në Komunë, siç përcaktohet me nenet: 7 dhe 9 të Ligjit për përdorimin e gjuhëve.

Neni 2

2.1 Në hartimin e kësaj Rregulloreje janë përdorur përkufizimet e mëposhtme:

"Gjuhë zyrtare në Komunën e Malishevës": Gjuha shqipe dhe gjuha serbe dhe alfabetet e tyre, janë gjuhë zyrtare në këtë Komunë.

"Komunitet": Banorët brenda territorit të Komunës së Malishevës, të cilët i përkasin një grupi etnik,

kombëtar, gjuhësor ose religjioz, e që janë tradicionalisht banorë në territorin e Komunës.

"Organet përfaqësuese komunale": Kuvendi i Komunës dhe komitetet e tij.

"Organet ekzekutive komunale": Kryetari i Komunës dhe të gjitha organet vartëse (drejtoritë komunale, institucionet komunale të shëndetësisë primare dhe institucionet komunale arsimore, parashkollore, fillore dhe të mesme).

"Ndërmarrjet publike lokale": Ndërmarrjet publike që ofrojnë shërbime publike në emër të Komunës së Malishevës, siç është përcaktuar me Ligjin për ndërmarrjet publike 03/L - 087 - Lista 2 - Ndërmarrjet publike lokale të Komunës së Malishevës.

"Obligimet e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive komunale dhe të ndërmarrjeve publike komunale": Çdo organ përfaqësues dhe ekzekutiv dhe ndërmarrje publike e Komunës së Malishevës, siguron që përdorimi i gjuhëve zyrtare të bëhet në pajtim me nenet: 7 dhe 9 të Ligjit për përdorimin e gjuhëve zyrtare.

"Kërkesa për rishqyrtim": Kërkesa për rishikim të aktit administrativ dërguar personit përgjegjës për aktin administrativ, në pajtim me nenet 126 - 136 të Ligjit për procedurën administrative 02/L- 28.

"Ankesa": Ankesa administrative dërguar organit më të lartë administrativ në pajtim me nenet: 126 deri 136 të Ligjit për procedurat administrative.

II. PËRDORIMI I GJUHËVE

Shërbimet dhe dokumentet në gjuhët zyrtare

Neni 3

3.1 Përfaqësuesit e Komunës, organet ekzekutive si dhe ndërmarrjet publike lokale sigurojnë që secili qytetar mund të komunikojë me ta dhe të pranojë shërbime dhe dokumente publike në gjuhët zyrtare në Komunë. Për ta ushtruar këtë të drejtë, ata duhet të paraqesin kërkesë verbale ose me shkrim. Drejtoria e Administratës krijon procedura për të pranuar dhe plotësuar këto kërkesa përmes njësisë së përkthimit dhe mundësisë për përkthim simultan.

3.2 Kryetari, drejtorët e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive si dhe ata të ndërmarrjeve publike komunale, sigurojnë që shenjat që përmbajnë emërtimet zyrtare të institucioneve të tyre, të jenë të shkruara në të gjitha gjuhët zyrtare të Komunës dhe të vendosura në vende publike.

3.3 Organet kompetente të Komunës sigurojnë që, brenda territorit të komunës dhe në rrugët lokale, të gjitha shenjat që tregojnë apo përmbajnë emrin e Komunës, fshatrave, rrugëve apo vendeve të tjera publike, të jenë të shkruara në të gjitha gjuhët zyrtare të Komunës dhe të vendosura në vende publike, në pajtim me vullnetin e banorëve të atij vendbanimi.

Ankesat

Neni 4

4.1 Kërkesa për rishikim të akteve administrative ose pamundësisë së aplikimit të ndonjë norme që ka të bëjë me zbatimin e kësaj Rregulloreje dhe me zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve nga Komuna, duhet të adresohen te organi kompetent i Komunës, i cili përcaktohet në bazë të përmbajtjes së kërkesës, ose te ndërmarrja përgjegjëse për aktin e lëshuar.

4.2 Shtojcat që kanë të bëjnë me zbatimin e kësaj Rregulloreje dhe me zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve në Komunë, dërgohen te Komisioni i gjuhëve, me një kopje dërguar organit kompetent të Komunës, ose ndërmarrjes përgjegjëse për aktet administrative.

4.3 Komuna duhet të përgjigjet dhe të marrë vendime për rishikim dhe të sigurojë zbatimin e vendimeve të Komisionit të gjuhëve mbi ankesat, në pajtim me Ligjin për procedurat administrative.

Njësia e përkthimeve

Neni 5

5.1 Drejtoria e Administratës formon dhe siguron funksionimin e Njesisë së përkthimit. Njësia përbëhet nga përkthyesi dhe lektori, të cilët, për punën e tyre, i raportojnë drejtorit të Drejtorisë së Administratës.

5.2 Drejtoria e Administratës planifikon dhe kërkon burime buxhetore komunale për të siguruar rekrutimin, trajnimin dhe zhvillimin profesional të stafit të Njesisë së përkthimit. Drejtoria e Administratës siguron zyrë adekuate, pajisje dhe material shpenzues për Njësinë e përkthimit.

5.3 Drejtoria e Administratës, në pajtim me legjislacionin e zbatueshëm për Shërbimin Civil të Kosovës, nxjerr përshkrimin e punëve, sqaron përgjegjësitë dhe vlerëson performancën e stafit të Njesisë së përkthimit.

Organi kompetent për zbatimin e kësaj Rregulloreje në Komunë.

Neni 6

6.1 Drejtoriae Administratës është organi përgjegjës për zbatimin e kësaj Rregulloreje në Komunë.

6.2 Drejtoriae Administratës përgatit raport vjetor mbi zbatimin e kësaj Rregulloreje dhe të Ligjit për përdorimin e gjuhëve nga ana e Komunës. Raporti i dorëzohet Kryetarit të Komunës, Kuvendit dhe Komiteti për komunitete.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 7

Procedura për ndryshimin kësaj Rregulloreje bëhet në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe me Statutin e Komunës.

Neni 8

Kjo Rregullore nxirret në gjuhët zyrtare të Komunës.

Neni 9

Në rast të mospajtimeve mes dispozitave të kësaj Rregulloreje dhe Ligjit për përdorimin e gjuhëve, do të mbizotërojnë dispozitat e Ligjit për përdorimin e gjuhëve.

Neni 10

Kjo Rregullore miratohet me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm në mbledhje të Kuvendit.

Neni 11

Kjo Rregullore hyn në fuqi 7 ditë pas vlerësimit të ligjshmërisë së saj nga ana e MAPL-së.

Kryesuesi i Kuvendit

Kazip Begaj

